


TOLERANCA



NË DEMOKRACI

GAZETARËT NË DEMOKRACI


ODRIN (9), JONI (9), ELINA (9), YLLI (9), OLTİ (8), ISRA (9), DIAR (9)



Të gjithë njerëzve u nevojitet liria, prandaj të gjithë njerëzit duhet të jetojnë në demokraci

Demokracia paraqet të drejtat e popullit dhe jetën e barabartë mes tyre. Demokracia ka filluar në Athinë në vitin 507 para erës së re. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Në demokraci ka shumë të drejta dhe liri. Me liri kuptojmë lirinë e shprehjes, lirinë për të zgjedhur, lirinë e veprimit, etj. Me të drejta kuptojmë të drejtën për të jetuar, për t'u strehuar, për t'u ushqyer, të drejtën për arsim, të drejtën për punë. Por, nëse nuk do të ishte demokracia të gjithë popujt e të gjitha vendeve në botë do të ishin jo të lumtur dhe nuk do të kishin lirinë e jetës së përditshme. Në aktivitetin tonë si gazetarë, na ka bërë vizitë krye-

tari i Kuvendit të Kosovës z.Kadri Veseli. Ne, z. Veseli kemi bërë shumë pyetje dhe ai i është përgjigjur të gjithave. Në pyetjen se a ka marrëdhënie të mira me deputetët, ai tha se ka shumë marrëdhënie të mira me të gjithë deputetët. Ju faleminderit!



Demokracia me shumë ngjyra



Puna e gazetarëve të rinjë



Autorët e këtij artikulli

NE, QYTETARËT AKTIV


SUAD (8), JORIK (9), ARGITA (9), ANA (9), OLTIG. (9), ENI (9), ERA (9)

Ne kemi mësuar sot për Kushtetutën, Kuvendin, të drejtat tona dhe përgjegjësitë tona si qytetarë aktiv në Kosovë

Demokracia do të thotë popull udhëheqës. Kushtetuta është një libër i madh, ku shkruhen rregullat e miratuara nga Kuvendi dhe zbatohen nga Qeveria. Ajo garanton të drejtat tona. Të jesh qytetar i Republikës së Kosovës duhet të jeni të shkruar në regjistrin civil. Komunitetet janë grupe njerëzish që kanë nevoja të ngjashme dhe ato janë: komuniteti i fëmijëve, komuniteti i edukatorëve, komuniteti i aktorëve e shumë komunitete të tjera dhe të cilat duhet t'i respektojmë. Ne kemi shumë të drejta dhe përgjegjësi. Unë kam të drejtë të shkoj në shkollë, dhe kam përgjegjësi të shkojë për të mësuar. Unë kam të drejtë të kem çantë shkollore dhe kam përgjegjësi ta përdor çantën për të futur librat. Unë kam të drejtë të rregulloj shtratin

dhe kam përgjegjësi që ta mbaj pastër atë. Unë kam të drejtë të ushqehem dhe kam përgjegjësi ta pastroj tavolinën. Unë kam të drejtë të kem strehim dhe kam përgjegjësi ta ruaj atë.

Unë kam të drejtë të votoj dhe kam përgjegjësi të votoj drejtë. Unë kam të drejtë të luaj dhe kam përgjegjësi për të mbledhur lodrat. Unë kam të drejtë të kem roba dhe kam përgjegjësi t'i ruaj ato dhe t'i mbaj pastër. Unë kam të drejtë të trajtohem barabartë me të tjerët dhe kam përgjegjësi të sillem mirë me ta dhe t'i respektoj ata. Unë kam të drejtë të shëtis dhe kam përgjegjësi të mos bëj dëme në vendet të cilat i vizitoj. Mirëpo, edhe pse unë kam shumë të drejta, të gjithë kemi përgjegjësi të respektojmë të drejtat e të tjerëve.



Ne duhet ta pastrojmë ambientin tonë



Një nga përgjegjësitë tona



E drejta për të marrë pjesë në votim



Nxënësit e klasës IV-2

ZGJEDHJET NË DEMOKRACI

EURON (10), DRIT (9), LIS (9), AIOLA (10), EDA (9), GAZMEND (9), ERA (9), SEVDAIM (8)



Ne mësojmë për zgjedhjet

Votimi është proces i rëndësishëm, sepse përmes tij zgjedhen përfaqësuesit e vendit tonë. Të drejtën për të zgjedhur e kemi të gjithë pa dallim moshe, gjinie, feje, etj. Çdo njeri ka të drejtë të votoj atë që do pa ia imponuar askush, sepse është e drejtë e çdo njeriu të vendos vet se kë do ta votoj. Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet lokale. Ne sot mësojmë se zgjedhjet parlamentare janë zgjedhje kur ne i zgjedhim deputetët tonë. Ndërsa, zgjedhjet lokale janë zgjedhje që zhvillohen brenda komunës, ku zgjedhet kryetari i komunës dhe asambleistët.

Të drejtë vote kanë të gjithë personat në moshën 18 vjeçare, sepse në këtë moshë jemi më të pjekur. Personin të cilin duhet ta votojmë duhet të jetë i drejtë, i

sjellshëm, i mençur, bamiërës, i respektueshëm dhe të jetë udhëheqës i mirë.

Ne sot mësojmë edhe për demokracinë. Edhe e drejta për të votuar është demokraci. Prandaj, zgjedhjet janë element shumë i rëndësishëm i një shteti dhe ne duhet të dijmë se si duhet të votojmë në të ardhmen kur të jemi 18 vjeç.

Ne sot kemi pasur për vizitë Kryetarin e Kuvendit të Kosovës z.Kadri Veselin, i cili u përgjigj në pyetjet tona. Në pyetjen se si është ndjenja të jesh Kryetar i Kuvendit të Kosovës, kryetari u përgjigj se është ndjenjë shumë e mirë. Sot jemi shumë të lumtur, sepse mësojmë shumë gjëra të reja për zgjedhjet. Ne po ashtu, do ta vizitojmë Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kjo ishte ditë shumë e mirë për të gjithë ne.



Ne duke punuar për temën tonë



Autorët e grupit të zgjedhjeve


DEPUTETËT E RINJË

ANILA (9), ARTIOL (9), BLEART (9), ERZA (9), DIONIS (9), ORION (9), REUDA (9), YLLI (9)

Pyetjet që ne ia parashtriam Kryetarit Veseli ishin: Cili është roli juaj si Kryetar i Kuvendit dhe si është një ditë zakonshme e juaja në Kuvend?

Sot patëm për vizitë kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, i cili na ftoi në Kuvend dhe na tha se Kuvendi është i hapur për të gjithë ne. Ai u përgjigj në të gjitha pyetjet që ne ia parashtriam.

Ne sot kemi mësuar për demokracinë, po ashtu se si duhet të funksionojnë institucionet në vendet demokratike. Ne do t'iu tregojmë se si funksionon Kuvendi i Kosovës, se si zgjedhen deputetët, sa është mandati i tyre si deputetë etj. Të gjitha këto i gjeni tek vizatimi që kemi bërë për Kuvendin. Kuvendi i Republikës së Kosovës ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“, sepse populli përmes votës i zgjedhin përfaqësuesit e tyre që janë deputetët.




Kandidati për deputet duke shpallur programin e tij



Duke mësuar për Kuvendin



Orioni duke i treguar Aniles se çka është Kuvendi



Një punim nga grupi për Kuvendin



Puna në grup



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IV-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë